



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

- Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit.-

Numër:01-060/01-27747

Pejë, datë: 17. Prill 2024.

PROCESVERBAL

Nga takimi i III-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit të KK Pejë, i mbajtur me datë: 17. Prill 2024, me fillim në orën 13:00 h.

Takimi u mbajt në Zyren e KPF-ca të KK. Pejë.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesja znj. Valbona Avdijaj.

Kryesuesja, fillimisht konstatoi se në takim prezentojnë të 9 (gjasht) nga 7 (shtat) anëtarët e Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit, mungon me arsye z. Adnan Daciq.

Pos anëtarëve të KKMM. Prezentojn: z.Agron Dreshaj, drejtor teknik i NPR. “Hidrodrini” Pejë.

Pas konstatimit të kuorumit për mbajtjen e takimit, kryesuesja znj. Valbone Avdijaja, hapi takimin e KKMM. dhe për këtë takim propozoi dhe nga të pranishmit njëzërit pa vërejtje, u miratu ky

REND DITE :

- 1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshilëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesat.**
- 2) Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i II- rë i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, mbajtur me datë:29. Mars 2024.**
- 3) Shqyrtimi i gjendjes – cilesisë së ujit të pijes në Komunën e Pejes dhe furnizimit me ujë pijes.**
- 4) Çështje të ngritur në mbledhje nga udhëheqësi apo anëtarët.**

I.

Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesa.

Në këtë takim prezentojn 6 (gjashtë) nga 7 (shat) anëtarët e KKMM-it, mungon me arsye: z. Senad Daciq.

II.

Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i II-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, i mbajtur me datë: 29. Mars 2024.

Procesverbali u miratua njëzërit pa vërejtje.

III.

Shqyrtimi i gjendjes – cilësisë së ujit të pijes në Komunën e Pejes dhe furnizimit me ujë pijes.

Në diskutim muarrën pjesë:

z. Agron Dreshaj drejtor teknik i NPR. “Hidrodrini” Pejë, informoi anëtarët prezent të KKMM-sit mbi furnizimin e qytetit të Pejës, me ujë të pijës, burimet dhe mënyrën e furnizimit me ujë nga f.Radavc, Uji i zi si dhe një pjesë tjetër nga Lumbardhi. Për sasinë e ujit të pijës, cilësin e ujit, kërkesat për ujë, mungesat të cilat do të paraqiten në periudhën në vijim për shkak të rritjes së kërkesës dhe numrit të banorëve, zvoglimit të sasisë së ujit në burimet furnizuese. Informoi për keqpërdorimet e ujit, burimeve të ujit etj. për masat e ndërmarra nga ndërmarrja për eliminimin e këtyre dukurive, si çkyqja e konsumatorëve ilegal dhe ndëshkimi i tyre.

Ai theksoi se 6 (gjashtë) inspektor janë të angazhuar gjatë gjith kohës në terren në mbikqyrje, në mënyrë që me kohë të ndërmirën masat për parandalimin e dukurive negative dhe keqpërdorimeve të ujit të pijes, me kyqje ilegale dhe moslejimin e shfrytëzimit të ujit për qellime tjera të palejuara, sidomos në kohët dhe stinën kurr bie niveli ujit për arye klimatike etj.

Njëkohësisht informoi për mënyrën e menaxhimit të ujit, kontrollit të kualitetit dhe cilësisës së tij, duke theksuar se uji gjatë gjith kohës i nënshtrohet kontrollit të cilësisë dhe se cilësija e ujit të pijes në komunën tonë është në suaza të parametrave normal dhe në cilësi të lejuar për konsumim. Sa i përket kualitetit të ujit, theksoi se: analizat kryhen nga ndërmarrja por edhe nga Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike.

Ai theksoi, se: ujë ka mjaft në sasi, por në periudhën e verës ka me qenë sfidë për ujin e pijes, për shkak se uji në burimet furnizuese bie. Por sidoqoft, duhet marr masa dhe duhet apeluar tek qytetarët që uji i pijës sidomos gjatë stinës së verës, të shfrytëzohet në mënyrë racionale dhe të

mos keqpërdorët për të mos shkaktuar pastaj mungesa të kohë paskohsme të ujit të pijes dhe furnizimit të rregullt.

Z. Dreshaj, njëkohësisht dha përgjigje edhe në çështjet e ngritura nga anëtarët e komitetit, si:

- znj.Sauda Pantinaj, për kanalet e hapura, mirrëmbajtjen dhe gjendjen e tyre,
- znj. Fëllënëza Porimçaku Gashi, për planët dhe miratimin e tyre, si dhe
- znj. Valdrine Gashi, për çështjen e bunarëve, cilësinë e ujit të tyre dhe a aplikohet kontrolli i cilësisë së ujit në bunare bayuar në analiza profesionale etj.

Pas informimit detal lidhur me ujin, sasin e ujit, kontrollet, mangesit, problemet me furnizim, dukurit negative, si shfrytëzimi ilegal dhe legalizimi i shfrytëzimit nga format jo legale, nëvojat për racionalizim të shfrytëzimit të ujit të pijes në periudhat kurr furnizimi me ujë pakësohet për shkak të kushteve klimaterike, si dhe për Planët e biznesit e planifikimet tjera në përmirësimin e kushteve për furnizim me ujët të pijes në Komunën e Pejës etj. kjo pik u përmbyllë si informative për komitetin.

VI.

Çështje të ngritur në mbledhje nga udheheqësi apo anëtarët.

Anëtarët KKMM.-sit znj. Valdrine Gashi dhe znj. Sauda Pantinaj dhe kryesuesja Valbona Avdijaj, sugjeruan që për shqyrtim në rend dite për seancën e radhës të jetë:

- Shqyrtimi i çështjes së kanaleve të hapura, kanaleve për ujitje, mirrëmbajtja dhe rregullimi i tyre konform nëvojave për këtë,
- Shqyrtimi i çështjes së cilësisë së ajrit, nivelit të ndotjes etj.
- Mirëmbajtja e pastertisë së hapsriave publike dhe pastrimi i mbeturinave inerte etj.,
- si dhe shqyrtimi i çështjeve konform planifikimit për vitin 2024 me Planin e KKMM.

Mëqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës, e propozime tjera nuk pat, kryesuesja e takimit znj. Valbona Avdijaj, e shpalli të mbyllur këtë takim në orën 15,10 h.yrtimi i çështjes së kana

Pejë, dt.17. prill 2024

**Procesmbajtësi,
Fëllënza Podrimçaku Gashi**

**Kryesuesja e KKMA.
Valbona Avdijaj**